

## Vendim nr. 136 datë 21.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 21.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (L) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** LILI PROKO

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 122, datë 23.01.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-159, datë 16.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3, 4, 15, 18, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 71 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të vendimit nr. 22, datë 31.07.1995 të Këshillit Bashkiak Tiranë, me autorizimin nr. 9905 prot., datë 08.08.1995 të Drejtorisë së Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Tiranë, kërkuesit rezultoi se i është dhënë një apartament një dhomë e një kuzhinë në qytetin

e Tiranës. Për këtë arsye, midis tij (kërkuesit) dhe Entit Kombëtar të Banesave (*EKB*) në datën 31.08.1995 është lidhur kontrata e shitjes së apartamentit të banimit me pagesë të menjëhershme, ku është përcaktuar çmimi i shitjes, i cili ka qenë në vlerën 11,698 dollarë amerikanë ose 1.085.688 lekë, të konvertuar me kursin zyrtar të shkëmbimit të lekut me dollarin në ditën e lidhjes së kësaj kontrate, kurs i cili ka qenë 92,81 lekë për 1 dollar. Po sipas kësaj kontrate, meqenëse kërkuesi ka pasur statusin “i pastrehë”, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 21.06.1994 “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore”, të ndryshuar (*VKM-ja nr. 291/1994*), i janë falur shpenzimet e bëra deri në datën 31.12.1992, me vlerë 577.661 lekë ose 6224,1 dollarë, si dhe i është zbritur 30% e vlerës reale të apartamentit.

2. Gjithashtu, rezulton se ndërmjet kërkuesit dhe *EKB*-së është lidhur edhe kontrata e shitblerjes e datës 01.09.1995, sipas së cilës kërkuesit i është shitur apartamenti në shumën 355.690 lekë, e cila është paguar njëherësh dhe është llogaritur në bazë të *VKM*-së nr. 291/1994, me 30% zbritje të vlerës reale të apartamentit. Kërkuesi, duke pretenduar që nga *EKB*-ja (palë e paditur në proces) nuk i është paguar subvencioni që i takon, i është drejtuar rrugës gjyqësore me kërkesëpadi me objekt pagim shume përfitimi (subvencion shtetëror).

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 6046, datë 28.10.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se padia është parashkruar dhe nuk mund të ngrihet. Sipas asaj gjykate, rezulton e provuar se paditësit (kërkuesit) i ka lindur e drejta e padisë në datën 01.09.1995, kur është formalizuar para noterit kontrata e shitjes së apartamentit me pagesë të menjëhershme e datës 31.08.1995 dhe, referuar nenit 117 të Kodit Civil (*KC*), nga ky moment fillon llogaritja e afatit të parashkrimit. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se *KC*-ja, në nenin 113 të saj, ka parashikuar se cilat janë llojet e padive që nuk parashkruhen dhe objekti që është paraqitur në këtë gjykim “Pagim shume” (përfitim subvencioni shtetëror) nuk përbën asnjë nga pikat e këtij neni. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 122, datë 23.01.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar në të njëjtën linjë për sa i përket afatit të ngritjes së padisë dhe duke e gjetur të drejtë përfundimin e arritur nga shkalla e parë se padia është e parashkruar. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se pretendimi i paditësit (kërkuesit) parashtruar në ankim, se e drejta e padisë nuk është parashkruar, pasi ajo është e paparashkrueshme, është i pabazuar. Sipas Gjykatës Administrative të Apelit kemi të bëjmë me një padi detyrimi, ku, sipas nenit 420 të *KC*-së, detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji dhe paditësi (kërkuesi) pretendon se

detyrimi ka lindur nga ligji, për rrjedhojë, duke qenë kjo një padi detyrimi, i nënshtrohet afateve të parashkrimit të përgjithshëm prej 10 vjetësh, meqenëse nuk ka një afat të posaçëm parashkrimi të parashikuar nga ligji. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka bërë rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-159, datë 16.01.2024, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Në datën 23.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

6.1. *E drejta e aksesit, e drejta për t’u dëgjuar, e drejta e mbrojtjes, si dhe parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, duke iu mohuar e drejta për të marrë përgjigje për pretendimet e ngritura. Çështja e parashkrimit të padisë nuk është ngritur gjatë procesit gjyqësor dhe në këto kushte kërkuesit i është mohuar e drejta për të paraqitur prapësime, argumente dhe prova në lidhje me të.

6.2. *Parimi i paanshmërisë*, pasi vendimet e gjykatave janë marrë jashtë kuadrit të provave që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe në interpretim e vlerësim të njëanshëm të tyre. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë administruar si provë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3340, datë 26.07.2002 dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 372, datë 20.03.2003.

6.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e gjykatave nuk janë bazuar në ligj dhe në prova. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë bërë një shqyrtim të përshtatshëm të pretendimeve dhe provave të paraqitura nga palët, nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkuesi, si dhe nuk kanë arsyetuar lidhur me zbatimin e interpretimin e ligjit.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimimin e kërkuetit

7. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në këtë këndvështrim, kërkueti, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në jurisprudencën e saj, Gjykata ka vërejtur se ai përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Ky kriter përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkueti, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, për sa u përket pretendimeve të kërkuetit për cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës për t’u dëgjuar, së drejtës së mbrojtjes, parimeve të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si edhe *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, për procesin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, Kolegji konstaton se argumentet mbi të cilat ai ka ngritur këto pretendime i ka parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual, pa i parashtruar fillimisht në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, për këto argumente ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Për këtë arsye ai nuk legjitimohet për to. Ndërkohë, Kolegji vëren se kërkueti i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime edhe për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk

ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, ai legjitimohet për to.

11. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 16.01.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 23.04.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *parimit të paanshmërisë*, duke argumentuar se vendimet e gjykatave janë marrë jashtë kuadrit të provave që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe në interpretim e vlerësim të njëanshëm të tyre, si dhe nuk kanë administruar si provë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3340, datë 26.07.2002 dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 372, datë 20.03.2003.

13. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit (cenimin e parimit të paanshmërisë), Kolegji konstaton se ai nuk ka sjellë argumente të natyrës kushtetuese në verifikimin e testit *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe në verifikimin e testit *objektiv*, nëpërmjet të cilit shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të ansshmërisë. Gjithashtu, Kolegji vëren se argumentet e kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për këtë arsye, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, që lidhen me procesin e zhvilluar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Latë, ato do të shqyrtohen në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

#### *B. Për pretendimet e cenimit të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

15. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, duke iu mohuar e drejta për të marrë përgjigje për pretendimet e ngritura. Sipas tij, vendimi i Kolegjit Administrativ nuk është bazuar në ligj dhe në prova. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ nuk ka bërë një shqyrtim të përshtatshëm të pretendimeve dhe provave të paraqitura, nuk u ka dhënë përgjigje

pretendimeve të ngritura në rekurs, si dhe nuk ka arsyetuar lidhur me zbatimin e interpretimin e ligjit.

16. Në lidhje me të drejtën e aksesit, Gjykata ka theksuar se nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, para së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, e cila përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 18, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e saj, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i standardit të arsyetimit të vendimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Sipas Gjykatës, vendimet për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen nga Gjykata e Lartë në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim

me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë aspekt, Gjykata ka theksuar se detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i paraqitur nga kërkuesi. Në vlerësimin e shkaqeve të rekursit, Kolegji Administrativ i asaj gjykate, pasi i ka pasqyruar ato në pjesën hyrëse të vendimit të tij, ka arsyetuar se *i*) në rastin konkret përfundimet në të cilat kanë arritur gjykatat e shkallës së parë dhe ajo e apelit nuk janë kundërshtuar në rekursin e paraqitur nga pala paditëse (kërkuesi), sipas kërkesave që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012; *ii*) arsyetimi që kanë përdorur dhe konkluzioni në të cilin kanë arritur gjykatat do të mbetet i pakundërshtuar ligjërisht, përderisa rekursuesi (kërkuesi) nuk arrin të japë argumente për shkeljen e ligjit material e procedural apo shkeljet e rënda procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit e procedurën e gjykimit; *iii*) gjykatat nuk rezultojnë të kenë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, të mos kenë garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes apo të mos kenë sqaruar rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih paragrafin 14 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

20. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të aksesit nëpërmjet paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë. Forma e gjykimit “*në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve*” nuk ka ndikuar në të drejtën e aksesit të kërkuesit për të marrë përgjigje për pretendimet e ngritura, për sa kohë ai e ka ushtruar lirisht atë nëpërmjet paraqitjes së rekursit dhe për sa kohë Gjykata e Lartë i ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruar në të. Fakti se Gjykata e Lartë ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekurs nuk përfshihen në rastet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, nuk do të thotë që nuk i ka marrë në shqyrtim ato.

21. Për sa i përket arsytimit të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se edhe pse me një arsyetim të kufizuar, i cili sipas jurisprudencës kushtetuese nuk cenon standardin e arsytimit, ai tregon vendimmarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi

është haptazi i pabazuar. Në rastin konkret, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka ushtruar funksionin e tij për kontrollin e respektimit dhe interpretimit të ligjit procedural e material nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për këto arsye, Kolegji evidenton se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk cenon kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

22. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.